

POSTA SHQIPTARE SH.A
Nr. 15/3 Prot.
Datë 8.10.2019

Posta Shqiptare sh.a.

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

Së bashku me raportin e audituesit të pavarur

PËRMBAJTJA

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR	1-4
PASQYRAT FINANCIARE :	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	5
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE	6
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	7
PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË	8
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	9 – 29

<i>Aida Maloku</i>	<i>Diana Ylli (Golemi)</i>	<i>Irena Hoxha (Pulo)</i>	<i>Vullnetare Cela</i>	<i>Armand Avdolli</i>	<i>Bujar Osmani</i>
Adresa: Rr. Mujo Ulqinaku Pall. 18/1, Fier	Adresa:Rr.Emin Duraku,Pallati Binjakët, Nr.1, Hyrja Nr.5, Kati 2, Tiranë	Adresa:Rr.Emin Duraku,Pallati Binjakët, Nr.1, Hyrja Nr.5, Kati 2, Tiranë	Adresa:Rr.Komuna e Parisit, Kompleksi Kika, Kulla nr.4, kati i 4, Tirane	Adresa: L.Beqir Dardha, Pall. 88/8, Ap.12, Elbasan	Adresa: Rruga Milto Tutulani, Pallat i ri, Kati 2 Tirane

RAPORTI AUDITUESVE I TË PAVARUR Për Drejtuesit dhe Aksionerin e POSTA SHQIPTARE sh.a.

Opinion me Rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë Posta Shqiptare (Shoqëria) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financier më datën 31 dhjetor 2018, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllt në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përbledhje të politikave kontabël më të rendësishme.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në bazat për opinion me rezervë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financier të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2018, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllt në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin me Rezervë

- Siç është paraqitur në shënimin nr. 6 dhe 7 të pasqyrave financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2018, Aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale paraqiten në vlerën 2,471,042 mijë lekë (31 dhjetor 2017: 2,509,142 mijë lekë).

Shoqëria ka zgjedhur metodën e rivlerësimit për të matur vlerën e aktiveve afatgjata materiale për disa nga aktivet të veta, por jo të gjitha aktivet e përfshira në një kategori specifike.

Kjo mënyrë rivlerësimi nuk është në përputhje me SNK 16 Aktive Afatgjata Materiale i cili kërkon që nese një aktiv afatgjatë rivlerësohet, duhet të rivlerësohet e gjithë kategoria e aktiveve afatgjata materiale të cilës ai i përket.

Shoqëria i ka rivlerësuar pjesërisht aktivet afatgjata në vitin 2013. Ndërkohë që, SNK 16 Aktive Afatgjata Materiale kërkon që nese një kompani zgjedh metodën e rivlerësimit për matjen e aktiveve me vlerën e drejtë, atëherë rivlerësimi i aktiveve duhet të kryhet me një rregullsi te mjaftueshme që të sigurojë që vlera kontabël të mos ndryshojë materialisht nga vlera e drejtë.

Si rrjedhojë e çështjeve të përmënduar më sipër, ne nuk jemi në gjendje të gjukojmë mbi plotësinë, ekzistencën dhe vlerësimin e shumës së paraqitur në këto pasqyra financiare.

- Në kapitalet e shoqërisë është paraqitur rezerva e rivlerësimit të aktiveve afatgjata materiale në vlerën 1,138,684 mijë lekë (31 dhjetor 2016: 1,199,012 mijë leke). Kjo rezervë nuk është e perditesuar me të gjitha ndryshimet e ndodhura pas rivlerësimit të Aktiveve Afatgjata Materiale nga viti që është bërë rivlerësimi e deri më tani. Shuma e mësipërme do duhej të ishte pakësuar për tepriçën e mbetur nga rivlerësimi, për të gjitha rastet e aktiveve të shitura apo të nxjerra jashtë përdorimit, duke e transferuar këtë shumë brenda kapitaleve të veta në zërin e fitimeve të mbartura. Si rrjedhojë rezerva e rivlerësimit paraqitet e mbivlerësuar dhe fitimet e mbartura të nënvlérësuara në të njejtën masë.

Si rrjedhojë, ne nuk jemi në gjendjë të vlerësojmë efektet e korigimeve të mundëshme në rezervën e rivleresimit.

- Siç është paraqitur në shënimin nr. 9 të pasqyrave financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2018, inventari paraqitet në vlerën 220,670 mijë Lekë (31 dhjetor 2017: 179,065 mijë Lekë). Ne jemi kontraktuar si auditues pas datës 31 dhjetor 2018 dhe si rrjedhojë nuk morëm pjesë në numërimin e inventarit fizik të realizuar nga shoqëria në mbyllje të vitit ushtrimor. Megjithë procedurat e tjera alternative të kryera për të verifikuar ekzistencën dhe saktësinë e ketij inventari, ne nuk ishim në gjendje të krijonim siguri të arsyeshme për vlerën e paraqitur në pasqyrat financiare të mbyllura në 31 dhjetor 2018.

<i>Aida Maloku</i>	<i>Diana Ylli (Golemi)</i>	<i>Irena Hoxha (Pulo)</i>	<i>Vullnetare Cela</i>	<i>Armand Avdolli</i>	<i>Bujar Osmani</i>
Adresa: Rr. Mujo Ulqinaku Pall. 18/1, Fier	Adresa:Rr.Emin Duraku,Pallati Binjakët, Nr.1, Hyrja Nr.5, Kati 2, Tiranë	Adresa:Rr.Emin Duraku,Pallati Binjakët, Nr.1, Hyrja Nr.5, Kati 2, Tiranë	Adresa:Rr.Komuna e Parisit, Kompleksi Kika, Kulla nr.4, kati i 4, Tirane	Adresa: L.Beqir Dardha, Pall. 88/8, Ap.12, Elbasan	Adresa: Rruja Milto Tutulani, Pallat i ri, Kati 2 Tirane

4. Siç është paraqitur në shënimin nr. 10 të pasqyrave financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2018, kërkesat e arkëtueshme tregtare janë në vlerën 930,663 mijë Lekë (31 dhjetor 2017: 983,624 mijë Lekë). Nga procedurat analitike rezulton që një pjesë e konsiderueshme e llogarive të arkëtueshme janë mbi 365 ditë të vjetra. Shoqëria nuk ka një politike për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme. Deri më datë 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017, shoqëria nuk ka njojur ndonjë shumë për zhvlerësimin e këtyre kërkeseve për arkëtim. Si pjesë e procedurave të auditimit, ne dërguam konfirmime direkte në palë të treta për shumat e arkëtueshme në vlerën 845,789 mijë lekë, dhe deri në datën e përgatitjes së ketij raporti nuk morëm konfirmime direkte ose dokumenta rakordimi nga palët e treta. Për keto arsyen ne nuk ishim në gjendje të fitonim siguri në lidhje me saktësinë e plotësinë e vlerave të arkëtueshme si më sipër përmendur. Në këto kushte, ne nuk jemi në gjendje të vlerësojmë efektin që ndonjë korrigim i mundshëm nga zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme do të kishte në pasqyrat financiare të shoqërisë. Shuma e zhvlerësimit deri në masën e vlerës së tyre të rikuperueshme do të ulte vlerën e aktiveve dhe të kapitaleve të veta në të njëjtën masë.
5. Siç është paraqitur në shënimin nr. 11 të pasqyrave financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2018, kërkesat e tjera të arkëtueshme paraqiten në vlerën 354,803 mijë Lekë (31 dhjetor 2017: 363,195 mijë Lekë), prej të cilave vlera prej 252,638 mijë lekë (31 dhjetor 2017: 240,365 mijë lekë) përfaqëson llogari të arkëtueshme nga të tretë dhe punonjës. Nga procedurat analitike rezulton që një pjesë e konsiderueshme e tyre janë mbi 365 ditë. Deri më datë 31 dhjetor 2018, Shoqëria nuk ka njojur ndonjë shumë për zhvlerësimin e këtyre kërkeseve për arkëtim. Për shkak të mangësisë së evidencës kontabël të vënë në dispozicion ne nuk jemi në gjendje të vlerësojmë efektin që ndonjë korrigim i mundshëm nga zhvlerësimi i mëtejshëm i llogarive të arkëtueshme do të kishte në pasqyrat financiare të Shoqërisë. Shuma e zhvlerësimit deri në masën e vlerës së tyre të rikuperueshme do ulte vlerën e aktiveve dhe te kapitaleve të veta në të njëjtën masë.
6. Siç është paraqitur në shënimin nr. 12 të pasqyrave financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2018, gjendja e mjeteve monetare në arkë dhe likuiditeteve të tjera te cilat perbehen nga pulla dhe letra me vlere, paraqitet respektivisht 755,280 mijë Lekë (31 dhjetor 2017: 619,900 mijë Lekë) dhe 151,860 mijë Lekë (31 dhjetor 2017: 170,059 mijë Lekë). Ne jemi kontraktuar si auditues pas datës 31 dhjetor 2018 dhe si rrjedhojë nuk morëm pjesë në numërimin e mjeteve monetare të realizuar nga shoqëria në mbyllje të vitit ushtrimor. Për shkak të mënyrës së ndjekjes së inventarit të këtyre aktiveve, ne nuk jemi në gjendje të fitojmë siguri mbi saktësinë e plotësinë e gjendjeve të mjeteve monetare më 31 dhjetor 2018 dhe 2017.
7. Me 31 dhjetor 2018 shoqëria ka detyrime për çështje gjyqësore të hapura me punonjës të larguar dhe subjekte te tjera tregtare për vlerën 66,074 mijë Lekë, për të cilat departamenti Ligjor konfirmon që janë çështje të humbura në shkallën e parë dhe të apeluara në shkallën më të lartë të gjykimit. Shoqëria nuk ka krijuar një provizion për këto çështje gjyqësore. Në gjykimin tonë shuma e provizioneve me 31 dhjetor 2017 për këto detyrime duhet të ishte në vlerën totale të detyrimit dhe si rrjedhojë rezultati i periudhës ushtrimore dhe kapitalet e veta janë të mbivlerësuara për 66,074 mijë Lekë, ndërsa detyrimet janë nënvlerësuar për të njëjtën vlerë.
8. Shoqëria ka në përdorim disa ambiente të cilat janë pjesë e kapitalit të shoqërisë Albtelekom sh.a, Ministri i Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energetikës, në cilësinë e aksionerit me shkresën nr. 56081, datë 1.11.2010 dhe Urdhrin nr. 546, datë 11.06.2013 ka kërkuar dorëzimin e tyre tek shoqëria Albtelekom dhe heqjen përfundimisht nga lista e pasurive të paluajtshme të Shoqërisë. Menaxhimi i Shoqërisë ka pretendime në lidhje me ambientet dhe përrrjedhojë ka hapur çështje gjyqësore për të kundërshtuar Urdhërin e Ministrit në Gjykatën Administrative të shkallës së parë e cila e ka rrëzuar pretendimin e saj. Nga Shoqëria nuk na u vu në dispozicion lista dhe vlera e pasurive të paluajtshme për të cilat është ngritur proces gjyqësor, përrrjedhojë ne nuk dimë efektet e mundshme që ngjarja e mësipërme mund të ketë në vlerën e aktiveve afatgjata materiale dhe kapitaleve të veta dhe në shënimet shpjeguese që duhen paraqitur në pasqyrat financiare për këtë situatë.

<i>Aida Maloku</i>	<i>Diana Ylli (Golemi)</i>	<i>Irena Hoxha (Pulo)</i>	<i>Vullnetare Cela</i>	<i>Armand Avdolli</i>	<i>Bujar Osmani</i>
Adresa: Rr. Mujo Uiqinaku Pall. 18/1, Fier	Adresa:Rr.Emin Duraku,Pallati Binjakët, Nr.1, Hyrja Nr.5, Katë 2, Tiranë	Adresa:Rr.Emin Duraku,Pallati Binjakët, Nr.1, Hyrja Nr.5, Katë 2, Tiranë	Adresa:Rr.Komuna e Parisit, Kompleksi Kika, Kulla nr.4, katë i 4, Tirane	Adresa: L.Begir Dardha, Pall. 88/8, Ap.12, Elbasan	Adresa: Rruga Milto Tutulani, Pallat i ri, Katë 2 Tirane

Gjithashtu ne nuk kemi informacion për të vlerësuar ndonjë detyrim të mundshëm që mund të lindë nga pretendimet e Shoqërisë Albtelekom si efekt i mosdorëzimit të këtyre aseteve te kjo shoqëri si dhe efektet që ai mund të ketë në rezultatin e shoqërisë.

9. Shoqeria ka marredhënje me administratat e disa vendeve të huaja për shërbimet ndërpostare. Të ardhurat nga shërbimet ndërkombetare paraqiten në këto pasqyra financiare në vlerën 202,123 mijë lekë (2017: 186,450 mijë Lekë) dhe shpenzimet postare ndërkombëtare që lidhen me to në vlerën 98,566 mijë Lekë (2017: 111,002 mijë Lekë). Shoqëria kryen regjistrimin e të ardhurave nga shërbimet ndërkombëtare dhe shpenzimet postare ndërkombëtare jo përgjatë periudhës kur ato përfitohen dhe ndodhin, por vetëm pasi janë bërë rakordimet mes palëve dhe është lëshuar fatura përkatëse. Në pasqyrat financiare të periudhës paraqiten një pjesë e konsiderueshme e të ardhurave nga shërbimet ndërkombëtare dhe shpenzimeve postare ndërkombëtare që i takojne periudhave te meparshme si dhe nuk paraqiten ato që i takojnë periudhës që mbyllte me 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017. Ne nuk mundëm të siguronim informacion për të ardhurat nga shërbimet ndërkombëtare si edhe shpenzimet postare ndërkombëtare, ose të verifikonim me procedura alternative auditimi të ardhurat nga shërbimet ndërkombëtare si edhe shpenzimet postare ndërkombëtare të paraqitura në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirësë më 31 dhjetor 2018 dhe 2017. Për rrjedhojë ne nuk ishim në gjendje të percaktonim nëse do ishin të nevojshme korrigjime në pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2018 dhe 2017.
10. Siç është paraqitur në shënimin nr. 15 të pasqyrave financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2018, gjendja e llogarive tregtare të pagueshme paraqitet në vlerën 474,907 mijë Lekë (31 dhjetor 2017: 418,443). Si pjesë e procedurave të auditimit, ne derguam konfirmime direkte në palë të treta për shumat e llogarive të pagueshme në vlerën 425,642 mijë lekë, dhe deri ne datën e perbatjes se ketij raporti nuk morëm konfirmime direkte ose dokumenta rakordimi nga palët e treta per llogarite e pagueshme ne vleren 199,710 mijë lekë. Për keto arsyе ne nuk ishim në gjendje të fitonim siguri në lidhje me saktësinë dhe plotësinë e vlerave të pagueshme si më sipër përmendor. Për rrjedhojë ne nuk jemi në gjendje të vlerësojmë ndonjë efekt që mund të rezultonte nga ndonjë korrigjim i mundshëm i tyre, në pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2018 dhe 2017.
11. Siç është paraqitur në shënimin nr. 19, të pasqyrave financiare, vlera e llogarive të tjera të pagueshme është 1,361,740 mijë Lekë (31 dhjetor 2017: 1,576,295 Lekë), prej të cilave për detyrimet e tjera në vlerën 707,581 mijë Lekë (31 dhjetor 2017: 912,163 Lekë) ne nuk kemi mundur të arrijmë një siguri të arsyeshme për plotësinë dhe egzistencën e tyre nëpërmjet kryerjes së procedurave alternative te auditimit. Për rrjedhojë ne nuk jemi në gjendje të vlerësojmë ndonjë efekt që mund të rezultonte nga ndonjë korrigjim i mundshëm i tyre, në pasqyrat financiare te mbyllura më 31 dhjetor 2018 dhe 2017.
12. Në shënimet për pasqyrat financiare Shoqëria nuk ka paraqitur shënimet për instrumentat financiare në përputhje me SNRF 7, shënimet për palët e lidhura në përputhje me SNK 24 dhe shënimet për angazhimet dhe detyrimet e kushtëzuara në përputhje me SNK 37.

Përgjegjësitet e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për ato kontolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përvëç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale perveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e proçesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Aida Maloku	Diana Ylli (Golemi)	Irena Hoxha (Pulo)	Vullnetare Cela	Armand Avdolli	Bujar Osmani
Adresa: Rr. Mujo Ulqinaku Pall. 18/1, Fier	Adresa:Rr.Emin Duraku,Pallati Binjakët, Nr.1, Hyrja Nr.5, Kati 2, Tiranë	Adresa:Rr.Emin Duraku,Pallati Binjakët, Nr.1, Hyrja Nr.5, Kati 2, Tiranë	Adresa:Rr.Komuna e Parisit, Kompleksi Kika, Kulla nr.4, kati i 4, Tirane	Adresa: L.Beqir Dardha, Pall. 88/8, Ap.12, Elbasan	Adresa: Rruga Milto Tutulani, Pallat i ri, Kati 2 Tirane

Përgjegjësitetë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tonë janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mosbulimit të një anomali si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i mosbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësimë të qëllimshme, keqinterpretim, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasiguri materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tonë jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimive shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, perveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

08 tetor, 2019

EKSPERT-KONTABEL
I AUTORIZUAR
AIDA-MALOKU.



Irena Hoxha (Pulo)
Auditues Ligjor



Posta Shqiptare sh.a

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2018**

	Shënimi	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
AKTIVE			
Aktivet afatgjata			
Aktivet afatgjata materiale	6	2,413,528,149	2,441,665,957
Aktivet afatgjata jomateriale	7	57,514,310	67,476,138
Aktive afatgjata financiare	8	450,000,000	450,000,000
Totali i aktiveve afatgjata		2,921,042,459	2,959,142,095
Aktivet afatshkurtra			
Inventarët	9	220,669,790	179,064,890
Llogari të arkëtueshme tregtare	10	930,662,909	983,623,760
Llogari të arkëtueshme të tjera	11	354,802,665	363,194,510
Parapagime dhe shpenzime te shtyra	12	7,792,000	-
Mjete monetare	13	2,189,724,439	2,251,905,280
Totali i aktiveve afatshkurtra		3,703,651,803	3,777,788,440
Totali i aktiveve		6,624,694,262	6,736,930,535
KAPITALI			
Kapitali aksionar		3,006,363,000	3,008,624,000
Rezerva nga rivlerësimi		1,138,684,252	1,199,012,192
Rezerva ligjore		117,568,841	116,877,624
Rezerva të tjera		126,507	126,507
Fitime të pashpërndara		245,855,685	176,570,797
Fitime të ushtrimit		64,818,991	13,824,334
Totali i kapitalit	14	4,573,417,276	4,515,035,454
DETYSIMET			
Detyrime afatgjata			
Tatim i shtyrë	28	168,513,547	166,942,327
Totali i detyrimeve afatgjata		168,513,547	166,942,327
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	15	474,907,062	418,442,613
Detyrime tatimore	16	32,364,825	41,326,755
Detyrime ndaj punonjësve	17	6,504,855	7,952,885
Grante dhe të ardhura të shtyra	18	7,247,008	10,935,167
Llogari të pagueshme të tjera	19	1,361,739,689	1,576,295,334
Totali i detyrimeve afatshkurtra		1,882,763,439	2,054,952,754
Totali i detyrimeve		2,051,276,986	2,221,895,081
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		6,624,694,262	6,736,930,535

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 9 - 27, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Posta Shqiptare sh.a

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të Ardhurave Gjithpërfshirëse
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

	Shënimë	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura	20	2,515,292,083	2,403,022,727
Të ardhura të tjera jo operative	21	91,683	3,890,484
Total të ardhura		2,515,383,766	2,406,913,211
Materiale të para dhe të konsumueshme	22	(242,303,794)	(258,392,440)
Shpenzime personeli	23	(1,378,181,004)	(1,312,127,294)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	24	(162,137,667)	(157,681,153)
Shpenzime të tjera	25	(628,359,064)	(587,375,112)
Total shpenzime		(2,410,981,529)	(2,315,575,999)
Të ardhura /Shpenzime financiare neto	26	(9,606,102)	(57,804,833)
Fitimi/humbja para tatimit		94,796,135	33,532,379
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(29,977,144)	(19,708,045)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin aktual	27	(29,977,144)	(19,708,045)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin te shtyre		-	-
Fitimi/humbja e vtitit		64,818,991	13,824,334
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		(1,571,220)	8,310,920
Tatim fitime te shtyra nga rivleresimi i aktiveve afatgjata materiale		(1,571,220)	8,310,920
Totali i të ardhurave		(1,571,220)	8,310,920
të tjera gjithpërfshirëse për vitin		(1,571,220)	8,310,920
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		63,247,771	22,135,254

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 9 - 27, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

	Kapitali akcionar	Rezerva te tjera	Rezerva Liqiore	Rivlerësimi	Fitime te mbartura/ humbje te akumuluara	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2017	3,008,624,000	127,233	114,735,189	1,254,418,327	119,278,868	4,497,183,617
Fitimi i vitit						
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:				13,824,334	13,824,334	
Transferim në rezervë liqiore dhe të tjera				8,310,920	8,310,920	
Dividendë të paguar		2,141,709		(2,141,709)	(2,141,709)	
Rimarrje e rezerves se rivlerësimit				(4,283,417)	(4,283,417)	
Sisteme			(55,406,135)	55,406,135		
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017	3,008,624,000	126,507	116,877,624	1,199,012,192	190,395,131	4,515,035,454
Fitimi i vitit						
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:				64,818,991	64,818,991	
Zvogelim kapitali	(2,261,000)			(1,571,220)	(1,571,220)	
Transferim në rezervë liqiore dhe të tjera		691,217		(1,222,516)	(3,483,516)	
Dividendë të paguar				(691,217)		
Rimarrje e rezerves se rivlerësimit				(1,382,433)	(1,382,433)	
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018	3,006,363,000	126,507	117,568,841	1,138,684,252	310,674,676	4,573,417,276

Pasqyrat financiare duhet të lexohen sëbashku me shënimet shpjeguese të faqeve 9 - 27, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyrat financiare janë aprovuar nga Menaxhimii më 24.10. 2019 dhe janë nënshkruar për publikim në emër të tyre nga:


Z.Laert Duraj
Drejtor i Përgjithshëm




Zhj.Evis Brari
Dr/Drejtori së Ekonomikë dhe
Financës

**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

Shënimë	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	94,796,135	33,532,379
Axhustime për zërat jo-monetare:		
Amortizimi	162,088,345	157,681,153
Nxjerra jashtë përdorimit e mjeteve fikse, neto nga fitimi capital	27,407,411	4,237,687
Fitimi operativ përpala ndryshimeve në kapitalin qarkullues	284,291,891	195,451,219
<i>Ndryshimi në kapitalin qarkullues</i>		
Ndryshimi në inventar	(41,604,900)	(20,641,372)
Ndryshimi në llogari të arkëtueshme dhe të tjera	61,352,696	(208,083,150)
Ndryshimi në llogari të pagueshme dhe të tjera	(168,501,156)	(265,474,357)
Ndryshimi në grante dhe të ardhura të shtyra	(3,688,159)	(1,761,381)
Rënje/(rritje) në parapagime e shpenzime të shtyra	(7,792,000)	-
Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative	124,058,372	(300,509,041)
Tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit	(29,977,144)	(19,708,045)
Aktivitetet investuese	(29,977,144)	(19,708,045)
Blerje të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	(154,879,636)	(159,162,091)
Shitje e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	-	-
Mjetet monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues	(154,879,636)	(159,162,091)
Aktivitetet financuese		
Dividendë të paguar	(1,382,433)	(4,283,417)
Mjetet monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues	(1,382,433)	(4,283,417)
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	(62,180,841)	(483,662,594)
Mjetet monetare në fillim të periudhës	2,251,905,280	2,735,567,874
Mjetet monetare në fund të periudhës	13	2,189,724,439
		2,251,905,280

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 9 - 27, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria Posta Shqiptare sh.a është krijuar si shoqëri anonyme me Vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë Nr. 20718 datë 03/02/1992. Aksioner i Shoqërisë është Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitive përkatëse të Ligjit 7638 datë 19.11.1992, "Për shoqëritë Tregtare" dhe në vijim nga ligji Nr.9901 dt 14.04.2008, si dhe nga statuti i saj dhe legjislacioni shqiptar në fuqi. Shoqëria është gjithashtu institucion financiar jobankar i licensuar si e tillë nga Banka Qëndrore dhe raporton në mënyrë specifike për këtë qëllim.

Shoqëria kryen aktivitetin e saj në ambjente që janë në pronësi të saj. Aktivet e qëndrueshme pronë e saj përbëhen nga toka, ndërtesa, pajisje informatike, mjete transporti etj. Kapitali i Shoqërisë sipas vendimit të Gjykatës së Rrethit Tiranë përbëhet nga kontributet e aksionerit të vetëm, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes në shumën 3,006,363,000 lekë, i ndarë në 3.006.363 aksione me vlerë nominale 1,000 lekë secili, të cilat zotërohen 100% nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

Shoqëria Posta Shqiptare sh.a drejtohet nga Këshilli Mbikqyrës, i cili ka emëruar si Administrator të përgjithshëm Z. Laert Duraj.

Këshilli Mbikqyrës:

Emri	Funksioni
Adela Karapi	Kryetar
Irena Malolli	Anëtar
Diana Dervishi	Anëtar
Marinela Lika	Anëtar
Ergys Qirici	Anëtar
Hantin Bonati	Anëtar

Selia e shoqërisë është Rruga Rreshit Collaku Tiranë. Shoqëria është e regjistruar si person juridik ne Degën e Tatimpaguesve të Mëdhenj me NIPT J61924007N.

2. Bazat e përgatitjes

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

2.2. Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti për Interpretimet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("KIRFN") te BSNK-se.

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

2. Bazat e përgatitjes(vazhdim)

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit finansiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjera duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë pëershruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizonet

Provizonet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuan, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.5.3. Zhvlerësimi i inventarëve

Shoqëria vlerëson gjendjen e inventarit në qarkullim të ulët dhe inventarin i cili ka humbur vlerën e përdorimit për shkak të zhvillimeve teknologjike apo arsyeve të tjera, me synim për të përcaktuar masën e zhvlerësimit të inventarit, bazuar në përdorimin e ardhshëm të tij dhe ne llogaritjen e vlerës neto të realizueshme. Në rast se vlera neto e realizueshme e inventarit është më e ulët se vlera kontabël neto, ekziston një tregues që inventari është i zhvlerësuar. Shoqëria përdor gjykimin e saj për të përcaktuar masën e zhvlerësimit.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese axhustohen (rregullohen) në konform me ndryshimet në paraqitje në periudhën aktuale raportuese. Ndryshimet janë kryer për të paraqitur më mirë natyrën e biznesit të Shoqërisë. Ato aplikohen retrospektivisht.

3. Aplikimi i standardeve ndërkomëtare të raportimit finansiar të reja dhe të rishikuara

3.1. Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Adoptimi i SNRF 9 "Instrumentat Financiare"

Shoqëria ka adoptuar SNRF 9, Instrumentat Financiar, nga 1 janar 2018. Kompania zgjodhi të mos rishikojë shifrat krahasuese dhe ka njojur çdo rregullim të vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve finansiare në fitimet e mbartura të hapura që nga data e zbatimit fillestar të standardeve, më 1 janar 2018. Si rrjedhojë, kërkesat e rishikuara të SNRF 7, Instrumentat Financiarë: Dhënia e informacioneve shpjeguese është zbatuar vetëm për periudhën aktuale. Dhënia e informacioneve shpjeguese për periudhën krahasuese përsërit ato informacione shpjeguese të bëra në vitin paraardhës.

Adoptimi i SNRF 15 "Të ardhura nga kontratat me klientët"

Shoqëria vendosi të aplikojë metodën e thjeshtëzuar të kalimit në SNRF 15 dhe zgjodhi të zbatojë mjetet praktike të disponueshme për këtë kalim. Kompania aplikon SNRF 15 vetëm për kontratat që nuk ishin plotësuar deri më datën e aplikimit fillestar (1 janar 2018).

Adoptimi i SNRF 15 nuk rezulton në korrigjime të pasqyrave finansiare për shkak të arsyeve të mëposhtme:

- Kontabiliteti për modifikimin e kontratës: Kompania nuk ka pasur ndonjë ndryshim të kontratës për shkak të natyrës së kontratës ose shumave të arkëtueshme.
- Detyrime të performancës shtesë të identifikuara: Kompania siguron vetëm një detyrim për performance të veçantë, shitjen e mallrave.
- Kontabilizimi për komponentë të rëndësishëm të financimit: Kompania nuk ka kontrata ku periudha ndërmjet transferimit të shërbimeve të premtuara ndaj klientit dhe pagesa nga klienti e tejkalon një vit.
- Kontabiliteti për programet e besnikërisë së klientit: Shoqëria në kontratat me klientët e saj ka parashikuar zbritje me plotësimin e kushteve të volumit të mallrave te tregtuar gjatë vitit. Këto zbritje janë në baza vjetore dhe reflektohen brenda vitit finansiar dhe për pasojë nuk kanë efekte në përputhje me SNRF 15.
- Ndryshimet në kohën e njojjes së të ardhurave (nga përgjatë kohës në një pikë në kohë ose anasjelltas): Të ardhurat nga shitja e mallrave njihen në periudhën kontabël në të cilën behet dhe transferimi i kontrollit mbi mallrat e shitura. Koha e njojjes së të ardhurave mbetet e ngjashme me SNK 18.
- Kontabilizimi për rimbursimet: Kompania nuk zbaton rimbursime.
- Kontabilizimi për kostot e marrjes së kontratës: Shoqëria nuk ka ndonjë kosto për të lidhur një kontratë.
- Kontabilizimi për kostot e realizimit të kontratës: Shoqëria nuk ka asnjë kosto për të përmbushur një kontratë.
- Paraqitja e aktiveve dhe detyrimeve të kontratës: Aplikimi i SNRF 15 nuk ka ndonjë ndikim në Shoqëri që do të çonte në njojen e një aktivi apo detyrime të kontratës.

Standardet e ndryshuara në vijim hynë në fuqi për Shoqërinë më 1 janar 2018, por nuk kanë pasur ndonjë ndikim material në shoqëri:

- Ndryshimet në SNRF 2 "Pagesat e bazuara në aksione" (publikuar më 20 qershor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
- Ndryshimet në SNRF 4 - "Zbatimi i SNRF 9 Instrumentat Financiarë me SNRF 4 Kontratat e Sigurimeve" (publikuar më 12 shtator 2016 dhe efektive, varësisht nga qasja, për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018 për subjektet që zgjedhin të aplikojnë opzionin e përjashtimit të përkohshëm, ose kur njësia ekonomike së pari aplikon SNRF 9 për njësitë ekonomike që zgjedhin të zbatojnë metodën e mbivendosjes).
- Përmirësimet vjetore të SNRF 2014-2016 - Ndryshimet në SNRF 1 të SNK 28 (i publikuar më 8 dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
- KIRFN 22 "Transaksionet dhe paradhënia në monedhë të huaj" (publikuar më 8 dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).

3. Aplikimi i standardeve ndërkombe të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara (vazhdim)

3.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale (vazhdim)

- Ndryshimet në SNK 40 - "Aktivet Afatgjata Materiale të Investuara" (publikuar më 8 dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).

3.2 Standardet dhe interpretimet të lëshuara, por ende nuk janë adoptuar

Ka një numër standardesh dhe interpretimesh të cilat janë nxjerrë nga Bordi i Standardeve Ndërkombe të Kontabilitetit që janë efektive në periudhat e ardhshme të kontabilitetit që Kompania ka vendosur të mos i aplikojë më herët. Kompania planifikon ti aplikojë këto ndryshime kur të hyjnë në fuqi.

SNRF 16, Qiratë (publikuar më 13 janar 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019). Standardi i ri përcakton parimet për njohjen, matjen, prezantimin dhe paraqitjen e qirasë. Të gjitha qiratë pothuajse rezultojnë që qiramarrësi të ketë të drejtën e përdorimit të një aktivi në fillim të qirasë dhe, nëse pagesat e qirasë bëhen përgjatë kohës të marrë edhe financim. Rrjedhimisht, SNRF 16 eliminon klasifikimin e qirave si qira operacionale ose qira financiare siç kërkohet nga SNK 17 dhe, në vend të kësaj, prezanton një model të vetëm të kontabilitetit të qiramarrësit. Qiramarrësi do të kërkohet që të njohë: (a) aktivet dhe detyrimet për të gjitha qiratë me një afat më të gjatë se 12 muaj, përvèç nëse aktivi në fjalë është me vlerë të vogël; dhe (b) zhvlerësimin e aktiveve të marra me qira veç nga interesit për detyrimet e qirasë financiare në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse. SNRF 16 në thelb ka të njëjtat kërkesa me SNK 17 për trajtimin kontabël të qirave në këndvështrimin e qiradhënsit. Ndaj, një qiradhëns vazhdon të klasifikojë qiratë e tij si qera të zakonshme ose qira financiare dhe të bëjë llogaritjet bazuar në llojin e qerasë.

Ndryshimet që mund të janë relevante për Shoqërinë, por nuk pritet të kenë ndonjë ndikim të rëndësishëm në Pasqyrat Financiare Individuale të saj, janë paraqitur më poshtë:

- KIFRN 23 "Paqartësi mbi Trajtimet e Tatimit mbi të Ardhurat" (në fuqi më 1 janar 2019).
- Përmirësimet vjetore (cikli 2015-2017) (i detyrueshëm për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- Ndryshimet në SNRF 9 "Tiparet e Parapagimit me Kompensim Negativ" (në fuqi më 1 Janar 2019).
- Ndryshimet në SNK 19 "Ndryshimet e planit, kufizimet dhe vendbanimet" (të detyrueshme për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- Ndryshimet në SNK 28 "Interesat Afatgjatë në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta" (e detyrueshme për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve" (që zbatohen në mënyrë të detyrueshme për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021).

4. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

4.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
EUR/Lek	123.42	132.95
USD/ Lek	107.82	111.10
CHF/Lek	109.6	113.94
GBP/Lek	137.42	149.95
SDR/Lek	149.95	157.84

4.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksi që lidhet me to, përveç sic përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten sic përshkruhet më poshtë.

Një instrument finansiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin finansiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërise skadojnë, shfuqizohen ose anullohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitet financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij finansiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferençë midis kostos dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë përiudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferençë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kompensimi instrumentave financiare

Aktivet dhe pasivet financiare kompensohen dhe paraqiten neto në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm nëse ekziston një e drejtë ligjore për të kompensuar shumat e njohura dhe qëllimi që shlyerja të realizohet mbi baza neto, apo të realizohet aktivi dhe te shlyhet detyrimi njëkohësisht. Kjo vlen kryesisht për balancat ndaj/dhe nga operatorët e tjerë të telekomunikacioneve kombëtare dhe nderkombëtare, të cilat shlyhen në shumën neto, në përputhje me kontratat ekzistuese.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.3. Inventarët

Inventarët njihen me vlerën më të voglën mes kostos dhe vlerës neto të realizueshme.

Vlera e realizueshme neto është çmimi i shitjes i përllogaritur gjatë rrjedhës normale të biznesit minus kostot e përllogaritura përfundimin dhe realizimin e shitjes. Kostot e inventarit janë përllogaritur duke u bazuar në metodën e mesatares së ponderuar dhe përfshin shpenzimet e kryera gjatë blerjes së inventarit dhe e dërgimit të tyre në kushtet dhe vendodhjen ekzistuese.

4.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proçes" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi është illogaritur mbi vlerën e amortizueshme, e cila është kostoja e aktivit duke zbritur vlerën e mbetur. Amortizimi njihet në bazë të vlerës së mbetur, duke përdorur normat e përcaktuara nga manaxhimi.

Aktivet afatgjata materiale	Norma e amortizimit %	
	2018	2017
Ndërtesa	5	5
Makineri e pajisje	20	20
Mjete transporti	20	20
Mobilje dhe orendi	20	20
Pajisje elektronike	25	25

Amortizimi nuk aplikohet për tokën dhe punimet në proçes.

Metoda e amortizimit,jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi dhe ndryshohen në rast se efektet janë materiale.

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.4. Aktivet afatgjata jomateriale

Aktivet afatgjata jomateriale përfshijnë licensat dhe të drejtat përdorim.

Njohja dhe Matja

Licencat, të drejtat e përdorimit të cilat përfshohen nga shoqëria paraqiten me vleren e drejte minus amortizimin e akumuluar (shihni më poshtë) dhe humbjet e akumuluara nga zhvlerësimi, nëse ka.

Shpenzimet e mëpasshme

Shpenzimet e mëpasshme kapitalizohen vetëm në rastin kur shtojnë përfitimet e ardhshme ekonomike për aktivin specifik me të cilat ato lidhen. Te gjitha shpenzimet njihen si fitim/humbje kur ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirese duke përdorur metodën lineare mbi jetëgjatësinë e parashikuar të aktiveve jomateriale që nga data që janë të disponueshme përdorim.

Aktivet jo-materiale amortizohen me normën 15% mbi vlerën e drejtë.

4.5. Zhvlerësimi (Rënia në vlerë)

Shoqëria vlerëson në çdo datë raportimi nëse ka ndonjë tregues përvlerësimin e aktiveve. Në rast se evidentohen tregues të tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit. Përvlerësimi jomateriale që nuk janë të gatshme përdorim, vlera e rikuperueshme përllogaritet në çdo datë të bilancit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet atëherë kur vlera e mbartur e aktivit apo njësie gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësie gjeneruese e parasë është njësie më e vogel e identifikuveshme e grupit të aktiveve e cila gjeron flukse monetare në mënyrë të pavarur nga aktivet e tjera. Humbjet nga zhvlerësimet njihen në fitim/humbje. Vlera e rikuperueshme e një aktivit apo njësie që gjeron flukse paraje është më e madhja midis vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Përvlerësimi përdorim, flukset e ardhshme monetare të çmuara aktualizohen duke përdorur normën para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut përvlerësimi në kohë të parasë dhe rrezikun specifik të aktivit.

4.7. Të ardhurat

Të ardhurat njihen në masën që është e mundur që përfitime ekonomike do të hyjnë në Shoqëri dhe që të ardhurat mund të maten në mënyrë të besueshme, pavarësisht se kur bëhet pagesa. E ardhura matet me vlerë të drejtë të shpërblimit të marrë për shërbimin e kryer dhe mallrat e shitura, neto nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe zbritje të mundshme të shitjeve.

4.8. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfshohen jo rrugullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjata të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përvëç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

4.9. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.10. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesit nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesit njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesit mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

4.11. Tatimi mbi fitimin

Tatimi fitimi i viti përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përvèç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatemore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2018 është 15% (2017: 15%).

Tatimi fitimi i shtyrë përfaqëson diferençën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përllogaritet për të evidentuar diferençat e përkohshme që krijojnë për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatemore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatemore në fuqi mbi diferençën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatemore.

Gjendjet e shtyra tatemore maten me normat tatemore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferençat e përkohshme do të anullohen ose humbja tatemore e mbartur do të shfrytëzohet.

4.12. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridikcionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

4.13. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

4.14. Provizonet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen fluksete dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizonet përcaktohen duke skontuar fluksete përshtime të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizonet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizonet rimerren.

4.15. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënimë të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënimë për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nësë është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

5. Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit

Vlerësimet dhe gjykimet janë vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme dhe janë bazuar në eksperiencat historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë edhe pritshmërinë për ngjarjet e ardhshme për të cilat besohet të janë të arsyeshme në bazë të rrethanave.

Shoqëria bën vlerësime dhe supozime lidhur me të ardhmen. Rezultati i vlerësimeve kontabël, sipas përcaktimit, rrallë do të jetë i barabartë me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet të cilat kanë një risk të konsiderueshëm për shkaktimin e një sistemimi material në shumat e mbartura të aktiveve dhe detyrimeve brenda vtit të ardhshëm financiar janë trajtuar si më poshtë.

Tatimi mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Një gjykim i rëndësishëm është kërkuar për të përcaktuar vlerat e tatim fitimit të shtyrë. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar fiskal është i pasigurt. Kur rezultati përfundimtar tatimor ndryshon në mënyrë të rëndësishme me shumat të cilat janë regjistruar fillimisht, diferenca të tillë do të ndikojnë në aktivet dhe detyrimet aktuale ose të shtyra të tatim fitimit në periudhën në të cilën është bërë një vlerësim i tillë.

Jeta e dobishme për aktive afatgjata materiale

Sic është përshkruar në shënimin 4.4 Drejtimi i Shoqërisë ka rishikuar dhe vlerësuar jetën e dobishme të pronave, makinerive dhe pajisjeve në fund të çdo periudhe raportuese. Gjatë vitit aktual, Drejtimi ka vendosur që jeta e dobishme për aktive afatgjata materiale nuk ka ndryshuar.

Vlerësimi i modelit të biznesit

Modeli i biznesit orienton klasifikimin e aktiveve financiare. Gjatë vlerësimit të transaksioneve të shitjes, Kompania konsideron frekuencën, kohën dhe vlerën e tyre historike, arsyet për shitjet dhe pritet për aktivitetin e shitjeve të ardhshme. Transaksionet e shitjeve që kanë për qëllim minimizimin e humbjeve të mundshme për shkak të rrezikut të kredisë mund të jetë në përpjekje me modelin e biznesit objktivi i të cilit është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale. Shitet e tjera para maturimit, jo të lidhura me aktivitetet e administrimit të rrezikut të kredisë, janë gjithashtu në përpjekje me modelin e biznesit objktivi i të cilit është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale, me kusht që ato të janë të rralla ose të parëndësishme në vlerë, si individualisht dhe në tërësi.

Kompania vlerëson rëndësinë e transaksioneve të shitjes që nga fillimi i aktivitetit të saj të shitjes. Modeli i biznesit "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale dhe për të shitur" nënkupton që mjetet janë mbajtur për të mbledhur flukset e mjeteve monetare, por shitja është gjithashtu pjesë integrale për arritjen e objektivit të modelit të biznesit, sic janë menaxhimi i nevojave të likuiditetit, arritja e një kthimi të caktuar ose përpjekja e kohëzgjatjes së aseteve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë këto asete.

5. Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit (vazhdim)

Gjatë kalimit në SNRF 9, kompania identifikoi se:

- Reziqet kryesore të modelit të biznesit janë në përputhje me modelin "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale" me fokus në rrezikun e kredisë. Asnjë peshë nuk jepet për çmimin ose rrezikun e vlerës së drejtë;
- Deri më tani nuk ka pasur asnjë shitje aktivit finanziar. Shitjet do të ndodhin vetëm në përgjigje të përkqësimit të rrezikut të kredisë nga pala tjetër, që rezulton nga shkeljet e kritereve të brendshme të rrezikut të kredisë. Këto shitje do të ishin në përputhje me modelin "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale". Një shitje për shkak të plotësimit të nevojave të likuiditetit do të ishte rastësore. Prandaj, modeli i biznesit që lidhet me llogaritë e Arkëtueshme konsiderohet të jetë "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale".

Vlerësimi nëse fluksset e mjeteve monetare janë vetëm pagesa principali dhe interesit ("VPPI")

Përcaktimi nëse fluksset e mjeteve monetare të një aktivi finanziar janë vetëm pagesa principali dhe interesit kërkon gjykim.

Të arkëtueshmet tregtare të Kompanisë përfshijnë një fluks të vetëm të parasë, pagesën e shumës që rezulton nga një transaksion në fushën e zbatimit të SNRF 15, që konsiderohet të jetë principali. Rrjedhimisht, fluksset monetare që rrjedhin nga të arkëtueshmet plotësojnë testin VPPI të pagesave të principalit dhe interesit pavarësisht se përbërësi i interesit është zero.

Matjet humbjeve te parashikuara te kredise

Niveli i humbjeve nga zhvlerësimi llogaritet për llogaritë e arkëtueshme të matura me koston e amortizuar. Meqenëse të arkëtueshmet tregtare nuk përbajnë një komponent të rëndësishëm financimi, niveli i humbjeve do të llogaritet bazuar në humbjet e pritshme të kreditit. SNRF 9 lejon përdorimin e një matricë provisionesh në të cilën llogariten kostot e zhvlerësimit për llogaritë e arkëtueshme të vjetra ose të vonuara.

Posta Shqiptare sh.a

Shënimë mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
(Vlerat janë në Lek)

6. Aktivet afatgjata materiale

	Toka	Ndërtesa	Makineri dhe Pajisje	Mjetë transporti	Mobilje e Orendi	Pajisje informaticke	AQT në përcës	Totali
Kosto								
Gjendja më 1 janar 2017	379,999,919	1,929,366,997	114,740,137	146,854,406	209,753,506	362,422,364	91,880,174	3,235,017,503
Shtesa		11,791,932	18,609,016		51,708,733	32,060,642	44,991,768	159,162,091
Transferime		136,871,942	10,200			(10,200)	(136,871,942)	
Sistemime			(15,669,051)		15,669,051			
Pakësimë			(1,581,470)		(5,748,684)	(3,446,794)		(10,846,506)
Gjendja më 31 dhjetor 2017	379,999,919	2,078,030,871	116,108,832	146,784,848	271,382,606	391,026,012		3,383,333,088
Shtesa	-	-	-		39,849,820	78,281,470	29,782,220	154,879,636
Transferime			6,966,126		(8,460,139)	4,431,522		
Sistemime Interposta			4,028,617		(12,010,300)	(208,001,536)		(232,352,446)
Shtesa Interposta			(12,340,610)			10,873,960	112,216,305	181,900,949
Pakësimë			58,810,684			(14,107,869)	(6,889,901)	(45,701,830)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	379,720,919	2,074,046,763	165,934,974	133,982,571	287,528,078	371,063,872	29,782,220	3,442,059,397
<i>Amortizimi i akumuluar</i>								
Gjendja më 1 janar 2017	351,731,801	57,397,603	53,023,533	103,036,313	237,303,017			802,492,267
Amortizimi i vittit	80,972,539	7,430,504	19,413,762	22,394,957	15,571,958			145,783,720
Transferime			5,909			(5,909)		
Pakesime			(1,032,200)		(40,884)	(2,595,745)		(6,608,856)
Gjendja më 31 dhjetor 2017	-	432,704,340	63,801,816	72,396,411	122,835,525	249,929,039		941,667,131
Amortizimi i vittit	82,266,331	7,522,102	14,024,988	26,347,948	21,805,708			151,967,077
Sistemime Interposta		(8,042,977)	(1,061,663)	(6,093,369)	(141,075,289)			(156,273,298)
Shtesa Interposta			38,352,283	7,142,265	75,034,225			120,528,773
Transferime			2,713,881	(2,615,603)	(98,278)			
Pakësimë			(5,190,270)	(8,849,782)	(9,451,633)	(5,087,161)		(29,358,435)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	-	514,191,082	99,156,835	76,509,954	138,165,133	200,508,244		1,028,531,248
<i>Vlera neto kontabël</i>								
Gjendja më 31 dhjetor 2017	379,999,919	1,645,326,531	52,307,016	74,388,437	148,547,081	141,096,973		2,441,665,957
Gjendja më 31 dhjetor 2018	379,720,919	1,559,855,681	66,778,139	57,472,617	149,362,945	170,555,628	29,782,220	2,413,528,149

Posta Shqiptare sh.a**Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018****(Vlerat janë në Lek)****7. Aktive afatgjata jomateriale**

Balanca e aktiveve afatgjata jomateriale më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 paraqitet si më poshtë:

	AAJM	Total
Me kosto		
Gjendja më 1 janar 2017	115,112,313	115,112,313
shtesa	-	-
Pakësimë	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	115,112,313	115,112,313
shtesa interposta	159,440	159,440
Pakësimë	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	115,271,753	115,271,753
Amortizimi		
Gjendja më 1 janar 2017	35,738,705	35,738,705
Amortizimi i vtit	11,897,470	11,897,470
Kthim amortizimi	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	47,636,175	47,636,175
Amortizimi i vtit	10,172,743	10,172,743
sistemim	(51,475)	(51,475)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	57,757,443	57,757,443
Gjendja neto më 31 dhjetor 2017	67,476,138	67,476,138
Gjendja neto më 31 dhjetor 2018	57,514,310	57,514,310

8. Aktive afatgjata financiare

Aktivet afatgjata financiare më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Investime në shoqërinë Albtelecom sh.a	450,000,000	450,000,000
	450,000,000	450,000,000

9. Inventari

Gjendjet e inventarit më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Materiale të para	13,924,429	14,925,183
Materiale ndihmëse	109,169,121	100,339,482
Lëndë djegëse	4,055,726	6,495,486
Pjesë këmbimi	98,010	6,724,096
Inventar i imët	62,607,771	48,839,526
Mallra për shitje	30,814,733	1,741,117
	220,669,790	179,064,890

Posta Shqiptare sh.a**Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

(Vlerat janë në Lek)

10. Llogari të arkëtueshme tregtare

Balanca e llogarive të arkëtueshme tregtare të shoqërisë më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Klientë për shitje e shërbime	808,271,992	870,648,759
Kliente ne leke	122,390,917	112,975,001
	<u>930,662,909</u>	<u>983,623,760</u>

11. Llogari të tjera të arkëtueshme

Gjendja e llogarive të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 detajohet si më poshtë :

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Të arkëtueshme nga Banka e Shqipërisë për Bono Thesari	89,070,000	122,828,703
Tatim fitimi i parapaguar	8,854,641	29,340,905
TVSH e arkëtueshme Interposta	58,285,911	58,285,911
TVSH e arkëtueshme	4,240,038	-
Të drejtë ndaj personelit	103,971,457	87,891,301
Debitorë të tjerë marrëdhënie me sportelin	45,953,519	37,058,523
Të tjera kërkesa	44,427,099	27,789,167
	<u>354,802,665</u>	<u>363,194,510</u>

12. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Gjendja e parapagimeve dhe shpenzimeve te shtyra me 31 dhjetor 2018 paraqitet si me poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	7,792,000	-
	<u>7,792,000</u>	<u>-</u>

13. Mjete monetare

Balanca e mjeteve monetare më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Mjete monetare në banke	1,282,584,317	1,461,946,137
Llogari rrjedhese	1,282,584,317	1,227,242,375
Depozita me Afat	-	234,703,762
Mjete monetare në arkë	755,279,641	619,900,128
Likuiditete te tjera	151,860,481	170,059,015
	<u>2,189,724,439</u>	<u>2,251,905,280</u>

Posta Shqiptare sh.a**Shënimë mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

(Vlerat janë në Lek)

14. Kapitali

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Kapitali aksionar	3,006,363,000	3,008,624,000
Rezerva nga rivlerësimi	1,138,684,252	1,199,012,192
Rezerva ligjore	117,568,841	116,877,624
Rezerva të tjera	126,507	126,507
Fitime të pashpërndara	245,855,685	176,570,797
Fitime të ushtrimit	64,818,991	13,824,334
	4,573,417,276	4,515,035,454

15. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Detyrime ndaj furnitorëve vendas	-	361,206,007
Detyrime ndaj furnitorëve të huaj	474,265,502	56,595,046
Furnitorë për fatura të pambëritura	641,560	641,560
	474,907,062	418,442,613

16. Detyrimet tatimore

Detyrimet tatimore të Shoqërisë më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 vijojnë si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Detyrime për sigurime shoqërore	24,477,307	25,231,872
Tatim mbi të ardhurat personale	7,377,903	294,500
TVSH për t'u paguar	-	15,411,376
Tatim në burim	509,615	389,007
	32,364,825	41,326,755

17. Detyrimet ndaj personelit

Detyrimet ndaj personelit të Shoqërisë më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 vijojnë si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Detyrime për pagë	6,504,855	7,952,885
	6,504,855	7,952,885

18. Grante, të ardhura të shtyra e të tjera detyrime

Grante, të ardhura të shtyra e të tjera detyrime më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Të ardhura të shtyra	7,247,008	10,935,167
	7,247,008	10,935,167

19. Llogari të pagueshme të tjera

Llogaritë e tjera të pagueshme më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Detyrime për bono thesari	89,070,000	106,933,283
Detyrime për pensione	565,089,076	557,198,606
Detyrime per sherbimin nderkombetar	42,826,677	56,141,085
Detyrime per ndihme ekonomike	32,781,992	140,821,565
Detyrime per invaliditet	48,324,188	70,982,166
Detyrime ndaj drejtoreve arsimore	38,261,196	73,350,322
Detyrime ndaj njesive administrative	25,042,529	39,582,055
Detyrime te tjera ndaj bashkive	246,411,010	-
Detyrime ndaj OSHEE	86,515,010	98,230,957
Detyrime të tjera	187,418,011	433,055,295
	1,361,739,689	1,576,295,334

20. Të ardhura nga shitja

Të ardhurat nga shitja për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura nga shërbime postare	1,042,578,784	1,093,946,476
Të ardhura nga shërbime financiare	1,066,563,383	985,688,918
Të ardhura nga shërbime biznesi	55,740,646	40,308,517
Të ardhura nga shërbimi ekspres	143,215,051	96,629,297
Të ardhura nga shërbimi ndërkombëtar	202,122,664	186,449,519
Te ardhura nga eksporti	5,071,555	-
	2,515,292,083	2,403,022,727

21. Të ardhura të tjera jo operative

Të ardhurat e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura të tjera	91,683	3,890,484
	<u>91,683</u>	<u>3,890,484</u>

22. Materiale të para dhe të konsumueshme

Materiale të para dhe të konsumueshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Materiale të konsumuara	97,375,424	108,591,722
Kosto e pullës	8,426,813	8,567,931
Konsumi i inventarit të imët	4,945,072	7,356,428
Shpenzime karburanti	53,825,505	56,986,740
Koeficienti i kreditimit	77,730,980	76,889,619
	<u>242,303,794</u>	<u>258,392,440</u>

23. Shpenzimet e personelit

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 janë si më poshtë :

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Shpenzime për pagë	1,144,529,172	1,092,334,139
Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	190,036,778	185,148,052
Shpërblime për punonjësit	43,615,054	34,645,103
	<u>1,378,181,004</u>	<u>1,312,127,294</u>

24. Shpenzime amortizimi dhe zhvlerësimi

Shpenzimet e amortizimit dhe zhvlerësimit për vitin 2018 dhe 2017 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Shpenzime amortizimi	162,137,667	157,681,153
	<u>162,137,667</u>	<u>157,681,153</u>

25. Shpenzime të tjera

Shpenzimet e tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Shpenzime për energji elektrike dhe uje	41,463,728	35,531,902
Blerje sherbim internet	44,738,496	38,506,502
Shpenzime qeraje	28,613,850	37,660,053
Shpenzime per mirembajtje sistem sigurie dhe IT	50,202,697	50,891,475
Shpenzime për mirëmbajte dhe riparime	13,105,889	2,106,230
Shpenzime siguracioni	1,345,310	1,309,965
Shpenzime për udhëtime dhe dieta	27,742,270	21,370,388
Shpenzime telefonike	4,401,611	4,452,742
Shpenzime personel i jashtëm	22,246,810	12,717,019
Shpenzime për reklama dhe publicitet	12,137,768	6,292,461
Shpenzime transport	6,488,047	6,139,547
Shpenzime për ruanje objektesh	93,110,807	81,256,149
Shpenzime për komisione bankare	67,130,704	49,608,736
Shpenzime për sponsorizime	4,719,000	4,692,000
Shpenzime për agjent postar	336,270	3,470,276
Shpenzime postare ndërkombëtare	98,566,236	111,002,175
Shpenzime pritje, dhurata	2,663,308	6,836,019
Shpenzime gjoba dhe penalitete	27,940,521	33,168,508
Shpenzime për taksa	30,337,018	29,014,415
Vlera e mbetur e AAM-ve të dala	12,857,798	5,125,388
Shpenzime për licensa/kuotizacione	12,547,654	14,934,132
Shpenzime të tjera	25,663,272	31,289,030
	628,359,064	587,375,112

26. Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhura dhe shpenzime financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura nga interesat	1,897,664	2,651,661
Të ardhura nga këmbimet valutore	44,108,690	2,285,235
Të ardhura të tjera financiare	2,520,961	2,512,661
Të ardhurat financiare	48,527,315	7,449,557
Humbje nga këmbimet valutore	(139,943)	(1,381,990)
Shpenzime të tjera financiare	(57,993,474)	(63,872,400)
Shpenzimet financiare	(58,133,417)	(65,254,390)
Rezultati financiar	(9,606,102)	(57,804,833)

27. Tatimi mbi fitimin

Përllogaritja e tatimit mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 paraqitet si më poshtë :

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Fitimi para tatimit	94,796,135	33,532,379
Total shpenzime të panjohura	105,051,490	97,854,587
Shpenzime amortizimi	59,105,420	55,406,135
Shpenzime pritje percjellje	2,663,820	
Penalitetet, gjoba e demshperblime	26,759,300	33,168,508
Shpenzime dhurata e sponsorizime	-	686,029
Shpenzime të tjera	16,522,950	8,593,915
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	199,847,625	131,386,966
 Tatim fitimi @15%	 29,977,144	 19,708,045
	64,818,991	13,824,334

28. Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë i përllogaritur për vitin 2018 dhe 2017 lidhet me sa më poshtë:

	Pasqyra e Pozicionit finansiar		Pasqyra e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	
	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Rivleresimi i aktiveve afatgjata materiale	168,513,547	166,942,327		
Te ardhura/(shpenzime) tatimi te shtyre			(1,571,220)	8,310,920
Aktive/(pasive) tatimore te shtyre	168,513,547	166,942,327	(1,571,220)	8,310,920

29. Instrumentat finansiarë dhe manaxhimi i riskut finansiar

Aktivitetet e shoqërisë e ekspozjonë atë ndaj një sërë risqesh financiare si: risku i kreditit, risku i likuiditetit dhe risku nga monedhat e huaja. Shoqëria nuk perdon instrumenta finansiarë derivativë ose ndonjë formë tjetër mbrojtje ndaj këtyre risqeve.

Nuk ekziston një kuadër i mirëfilltë formal i implementuar nga shoqëria për manaxhimin e riskut. Manaxhimi i shoqërisë fokusohet më shumë në riskun e kreditit dhe riskun e likuiditetit dhe vepron rast pas rasti për të zbutur këto risqe dhe për të minimizuar humbjet.

29. Instrumentat finanziarë dhe manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

Objektivat dhe politikat e manaxhimit të riskut financiar

Një instrument finansiar është çdo kontratë që krijon të drejta për të marrë para ose asete të tjera financiare nga palët e tjera ose detyrimin për të dhënë asete të tjera financiare një palë tjetër. Instrumentat kryesore financiare të Shoqërisë konsistonin në para në dorë dhe në bankë, hua ndaj palëve të lidhura, llogari tregtare të arkëtueshme dhe të pagueshme dhe detyrime të tjera financiare. Instrumentat financiare krijojnë një risk për shoqërinë. Risqet më të rëndësishme me të cilat përballet shoqëria janë si vijon:

29.1. Risku i Likuiditeteve

Shoqëria gjeneron flukse të mëdha të parasë nga aktivitetet operative (psh nga mbledhja e kërkesave të arkëtueshme) në atë masë sa që beson se reziku i likuiditeteve nuk është domethënës.

29.2. Risku i normave të interesit

Risku i normës së interesit përbëhet nga risku qe vlera e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti finansiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në treg dhe riskut që maturitetet e aktiveve që mbartin interes të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që mbartin interes të përdorura për të financuar ato aktive. Zgjatja kohore përgjatë të cilës norma e interesit e një instrumenti finansiar është fiks, përcaktion se në çfarë mase është e eksposuar ndaj riskut të normës së interesit.

Kompania nuk është e eksposuar nga risku i normave të interesit.

29.3. Risku nga monedhat e huaja

Risku nga monedhat e huaja është risku që vlera e instrumentave financiare do të luhatet si pasojë e ndryshimeve në kurset e këmbimit të monedhave të huaja. Manaxhimi nuk është futur në ndonjë derivat për t'i vënë kufi këtij risku.

29.4. Risku i kreditit

Risku i kreditit është risku që një palë tjetër nuk do të jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj që rrjedhin nga një instrument finansiar ose marrëveshje klienti, duke çuar kështu në një humbje financiare. Shoqëria është e eksposuar ndaj riskut të kreditit për shkak të aktiviteteve operacionale të saj (pikësëpari prej llogarive të arkëtueshme) dhe prej aktiviteteve të saj financuese, që përfshijnë depozitat me bankat dhe institucionet financiare, transaksionet në monedha të huaja dhe instrumenta të tjerë financiare.

Risku i kreditit është i kufizuar në vlerën kontabël të aktiveve financiare në datën e raportimit.

30. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 dhjetor 2018 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

31. Ngjarje pas datës së raportimit

Në janar 2019 shoqëria ka kryer rivlerësimin e Aktiveve Afatgjata Materiale.

Më 31 dhjetor 2018 në datën e pasqyrave financiare dhe deri në datën e aprovizimit të tyre nuk ka ngjarje rregulluese të reflektuara në pasqyrat financiare ose ngjarje të tjera që janë materialisht të rëndësishme për të paraqitur në këto pasqyra.

POSTA SHQIPTARE
2784
Date 24.10.2019



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

POSTA SHQIPTARE SH.A.

KËSHILLI MBIKQYRËS

V E N D I M

Nr. 36 Date 24/10/2019

**MBI
MIRATIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË VITIT USHTRIMOR 2018 TË
POSTËS SHQIPTARE SH.A.**

Këshilli Mbikqyrës i Shoqërisë "Posta Shqiptare" sh.a., i përbërë nga:

BELINDA IKONOMI	Krytare
HANTIN BONATI	N/ Kryetar
ROZA NAUMI	Anëtare
VIKRITA ÇUTO	Anëtare
RUDOLF PAPA	Anëtar
ERGYS MISHA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24.10. 2019, ora 14.00, të zhvilluar në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Shoqërisë,

Në mbështetje të Ligjit Nr. 46. Date 07.05.2015 "Për Shërbimin Postar në Republikën e Shqipërisë", Ligjit Nr. 8237, datë 01.09.1997 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", i ndryshuar, Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", (i ndryshuar), të Statutit të Shoqërisë, Vendimin e KM "Për Këshillat Mbikqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore", pasi shqyrtoi dhe diskutoi relacionin e paraqitur nga Administratori i Shoqërisë, "Për Pasqyrat Financiare të vitit ushtrimor 2018" si dhe Raportin e Ekspertëve Kontabël të |Registruar për auditimin e Pasqyrave Financiare të vitit ushtrimor 2018 "

V E N D O S I:

1. Miratimin e Pasqyrave Financiare të shoqërisë "Posta Shqiptare" sh.a. dhe fitimin neto ushtrimor te vitit 2018 në vlerën 64,818,991 lekë
2. Përcjelljen e propozimit Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për shpërndarjen e fitimit neto 64,818,991 lekë si më poshtë:
 - Per krijimin e rezervës ligjore 5% në shumën 3,240,950 lekë
 - Rezervat për zhvillim 85% në shumën 55,096,122 lekë
 - Divident 10% 6,481,899 lekë

3. Ky Vendim hyn në fuqi pas miratimit të Pasqyrave Financiare nga Asambleja e Përgjithshme.

KËSHILLI MBIKQYRËS



BELINDA IKONOMI

KRYETARE

HANTIN BONATI

N/KRYETAR

VIKRITA ÇUTO

ANËTARE

ROZA NAUMI

ANËTARE

RUDOLF PAPA

ANËTAR

ERGYS MISHA

ANËTAR



Adresa: Rr. "Reshit Collaku", Nr. 4, Tiranë, Tel: 042 222 315, Kodi Postar 1001, www.postashqiptare.al